



BASHKIA
TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR.3 E PUNËTORËVE TË QYTETIT
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____, _____, 2018

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Datë: 15/01/2019

Nga: Drejtoria e Përgjithshme Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë

Për: Operatorin ekonomik “Alcani” Sh.p.k me NIPT J91505006Q

Adresa: Tirane, Kamez, Blloku Frutikulture, Rruga e Laknasit.

Procedura e prokurimit: E hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-97223-12-06-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër: Procedurë e hapur marrëveshje kuadër me objekt “Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje”, kohëzgjatja e kontratës deri më **31.12.2019** nga nënshkrimi i kontratës.

Fondi limit: **20 426 031** (njëzet milion e katërqind e njëzet e gjashtë mijë e tridhjetë e një) lekë pa tvsh.

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë Tiranë

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 31.12.2018

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë;

- 1) Operatori ekonomik **Climacasa Sh.p.k**, NIPT **L07805502F**, me seli ne Adresa: Rruga Kavajës, pranë urës së Teknologjikut, Tiranë, me ofertë ekonomike **19 391 112.10** (nëntëmbëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e dymbëdhjetë pikë dhjetë) **Lekë pa tvsh.**
- 2) Operatori ekonomik **“Sulollari” Sh.p.k me NIPT K01529003M** me seli ne Adresa: Rruga Muhamet Gjollësja, Pall.71/3, Tiranë, i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
- 3) Operatori ekonomik **Bolt Sh.p.k** me NIPT **K91517011V** me seli në Adresë: Rruga Dritan Hoxha, Blloku Gintash, Afër Gjinnazit Aleks Buda, Laprakë, Tiranë, me ofertë ekonomike **19 608 990** (nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) **lekë pa TVSH.**
- 4) **Operatori ekonomik “Alcani” Sh.p.k** me NIPT **J91505006Q**, me adrese Tirane, Kamez, Blloku Frutikulture, Rruga e Laknasit, me vlere **19 336 642.68** (nëntëmbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzet e dy pikë gjashtëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH.**

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- 1) Operatori ekonomik **Bolt Sh.p.k** me NIPT **K91517011V** me seli në Adresë: Rruga Dritan Hoxha, Blloku Gintash, Afër Gjinnazit Aleks Buda, Laprakë, Tiranë, me ofertë ekonomike **19 608 990** (nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) **lekë pa TVSH, përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**
 - ❖ Nuk plotëson pikën i) të kapacitetit teknik pasi Raporti i Testimit i paraqitur nuk është i lëshuar brenda 12 muajve të fundit sipas kërkesave të DST por më datë 06.05.2016 dhe ky raport testimi nuk është paraqitur në origjinal ose i njehsuar me origjinalin në përputhje me nenin 56 të ligjit nr.7829, datë 01.09.1994 “Për noterinë”, por vetëm fotokopje e shoqëruar me vërtetim përkthimi.
- 2) Operatori ekonomik **“Sulollari” Sh.p.k me NIPT K01529003M** me seli ne Adresa: Rruga Muhamet Gjollësja, Pall.71/3, Tiranë, i cili nuk ka paraqitur ofertë ekonomike., përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
 - ❖ Nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion sipas kërkesave të DST.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“Alcani” Sh.p.k** me NIPT **J91505006Q**, me seli në adresën; Tirane, Kamez, Blloku Frutikulture, Rruga e Laknasit, se oferta me vlerë **19 336 642.68** (nëntëmbëdhjetë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzet e dy pikë gjashtëdhjetë e tetë) **lekë pa TVSH**, e paraqitur për tenderin me objekt **“Blerje lëndë djegëse pellet për ngrohje”**, (marrëveshje kuadër), me afat të lëvrimit deri më **31.12.2019**, nga nënshkrimi i kontratës, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr.3 të Punëtorëve të**

Qytetit, Tiranë, Rruga 5 maji, pranë Tregut të Medresesë, për të lidhur draft marrëveshjen kuadër, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30(tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i draftit të marrëveshjes kuadër, marrëveshja kuadër do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar **Climacasa Sh.p.k, NIPT L07805502F**, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **19 391 112.10** (*nëntëmbëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind e dymbëdhjetë pikë dhjetë*) **Lekë pa tvsh**, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 09/01/2018

Ankesa:

Nuk ka pasur.

TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR

Feti Fanaj

